

C.V.

Kolonel Ardian Lulaj Komandant, Shkolla e Trupës, Bunavi Vlorë, prej 1 shkurt 2018.



Kolonel Ardian Lulaj ka lindur më 25 shkurt 1965, në qytetin e Vlorës.

Ka përfunduar studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”, dhe Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin “këmbësori”, në vitin 1988.

Gjatë karrierës së tij ushtarake ka kryer Kolegjin e Komandës dhe Shtabit në Leavenworth, Kansas të SHBA, dhe Kursin e Lartë Ekzekutiv të Sigurisë, në Qendrën e Studimeve Evropiane të Sigurisë “Marshall”, në Garmisch-Partenkirchen, Gjermani. Ka përfunduar studimet Master Shkencor në Mardhëniet Ndërkombëtare, në Universitin Albania në Tiranë, si dhe është në proces për të mbrojtur doktoratën në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Kolonel Lulaj, ka ndjekur dhe shumë kurse të tjera trajnimi dhe kualifikimi si brenda dhe jashtë vendit si: Kursin e Instruktorit të Gjuhës Angleze në San Antonio, Texas të SHBA; Kursin në nivel operacional të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak, në Kilkiz, Greqi, si dhe atë në Shkollën e NATO-s, në Oberammergau, Gjermani.

Kolonel Lulaj, ka kryer detyra të ndryshme komanduese nga nivel toge deri në atë të komandantit të batalionit, si dhe ka punuar në nivele të ndryshme shtabi dhe institucione ushtarake. Ai ka një përvojë të gjatë në fushën akademike duke ushtruar detyrat e pedagogut dhe Shefit të Studimeve Strategjike në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Kolonel Lulaj, nga viti 2014 deri në 31 korik 2017 ka qenë në detyrën e Atasheut Ushtarak të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, dhe prej 1 gusht 2017 deri më 31 janar 2018 ka qenë në detyrën e Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

Kolonel Lulaj, është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij të gjatë ushtarake, si dhe mban titullin “Qytetar Nderi” nga bashkia e Leavenworth, Kansas të SHBA.

Kolonel Lulaj, zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

Ai është i martuar me zonjën Eglantina dhe kanë tre fëmijë, Ilda 22 vjeç, Kristi 20 vjeç dhe Luka 17 vjeç.